



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

Nr. 1255/Prot.
11

Durrës, më 25.06/2021

NJOFTIM

**MBI NDRYSHIMIN E AFATETEVE TË PRANIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR KANDIDATËT
E PORTALIT "MËSUES PËR SHQIPËRINË" 2021**

Në zbatim të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë" 2021, Shkresa Nr.3375/1 prot, datë 23.06.2021 Për një ndryshim të afateve për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin "Mësues për Shqipërinë" 2021 ju bëjmë me dije si më poshtë:

- 1- Dokumentacioni sipas Shtojcës 1, të Udhëzimit nr. 12, do të dërgohet në rrugë postare në adresën e DRAP Durrës, brenda datës 30.06.2021.
- 2- Kandidati duhet të aplikojë online në portalin mesuespershqiperine.al deri me datë 30.06.2021. Kandidati ngarkon në platformën e aplikimit online dokumentet për konkurrim.
- 3- Një kopje e dokumentacionit të ngarkuar online, për efekt të vlerësimit të dosjes e dërgon në DRAP-në ku ka qendrën e banimit.
- 4- Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentat e detyrueshme për t'u ngarkuar online sipas shtojcës 1, nuk kalon në fazën tjetër të konkurimit.

SHTOJCA 1

1. Jetëshkrimi, (dorëzohet në momentin e punësimit)
2. Kërkesa me shkrim për konkurim sipas modelit të shtojcës 4 të udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021
3. Kopje e kartës së identitetit (e detyrueshme për tu ngarkuar online).
4. Raport mjeko-ligjor (i tre muajve të fundit dorëzohet në momentin e punësimit)
5. Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore sipas shtojcës nr.5 të këtij udhëzimi (dorëzohet në momentin e punësimit)
6. Vërtetim i qendrës së banimit (i detyrueshëm për tu ngarkuar online).

7. Kopje e librezës së punës (nëse ka, dorëzohet në momentin e punësimit).
8. Kopje e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe i dytë) ose të barasvlefshme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi (i detyrueshëm për tu ngarkuar online).
9. Kopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (i detyrueshëm për tu ngarkuar online).
10. Kopje e dëshmive të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtrë” (nëse ka, për tu ngarkuar online)
11. Kopje e çertifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Çertifikatat me kredite të trajnimeve të kryera Brenda vendit të jene ofruar nga MASR, institucioet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR (nëse ka, për tu ngarkuar online).
12. Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/vet ë huaja (nëse ka për tu ngarkuar online)
13. Deklarim nga kandidati për autorizimin e DRAP-së që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumentave të paraqitura sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 (I detyrueshëm për tu ngarkuar online)

Shënim: Dokumentet që ngarkohen në platformën e aplikimit online, janë të skanuara nga origjinali

DREJTOR
Ana DHAMO

